

Statutet e KNESHDM
(ndryshuar më 4 Dhjetor 2009)

Neni i parë

Komisioni Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe (KNESHDM) është një organizatë ndërqeveritare e cila gëzon zotësinë juridike. KNESHDM përbëhet nga të deleguarit e Shteteve Nënshkruese që lagen nga deti Mesdhe dhe nga detet që e përbëjnë këtë det si dhe nga të deleguarit e qeverive të Shteteve Nënshkruese që nuk lagen nga ky det, por që kryejnë hulumtime, studime dhe punë oqeanologjike në këtë det.

Pranimi në KNESHDM i Shteteve që nuk lagen nga deti Mesdhe bëhet me miratimin e dy të tretave të anëtarëve.

Presidenca e Komisionit i takon njërit prej Shteteve nënshkrues që laget nga deti Mesdhe.

Neni 1 bis

KNESHDM ka për objekt dhe qëllim që të kontribuojë në zbulimin dhe mbrojtjen e detit Mesdhe dhe deteve që lidhen me këtë det.

Për këtë qëllim:

- favorizon punimet hulumtuese në bashkëpunim me institutet kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare që kanë qëllime të ngjashme;
- nxit programet multilaterale të mbikëqyrjes së mjedisit detar;
- lehtëson shkëmbimet e informacionit dhe botimet veçanërisht në fushën e oqeanografisë, biologjisë ujore, gjeologjisë ujore dhe të biogjeokimisë.

Neni 2

Selia e KNESHDM ndodhet në Monako, vend në të cilin Komisioni gëzon privilegje, ndër të cilat paprekshmëria dhe pavarësia e veprimit, siç janë përcaktuar në Marrëveshjen e Selisë të nënshkruar më 4 Dhjetor 2009.

Neni 3

Shtetet nënshkruese, me anëtarësimin në KNESHDM, angazhohen për një periudhë pesëvjeçare e cila, me mbarimin e saj, ripërtërihet në heshtje për një periudhë tjetër prej pesë vjetësh me përjashtim të rastit kur Shteti, një vit përpara mbarimit të afatit, nuk shpall ripërtëritjen nëpërmjet një njoftimi që i dërgohet Drejtorit të Përgjithshëm, çdo pesë vjet.

Neni 4

Angazhimi si anëtar i KNESHDM sjell si pasojë detyrimin për të derdhur një kontribut vjetor të përcaktuar nga Byroja.

Neni 5

Çdo Shtet nënshkrues cakton me akt zyrtar të deleguarit kombëtar të tij.

Neni 6

Çdo shtet nënshkrues gëzon vetëm një të drejtë vote. E drejta e votës ushtrohet nga i deleguari, të cilit i është caktuar posaçërisht kjo e drejtë nga Shteti.

Neni 7

Byroja e KNESHDM përbëhet nga Presidenti, Drejtori i Përgjithshëm dhe të Deleguarit Kombëtarë.

Presidenti zgjidhet për gjashtë vjet nga Asambleja plenare dhe mandati i tij mund të ripërtërihet. Drejtori i Përgjithshëm emërohet nga Byroja, me propozim të Presidentit pas konsultimit të Komitetit të Ngushtë.

Shtetet anëtare që nuk përfaqësohen nga Presidenti, përfaqësohen nga një i Deleguar Kombëtar ose nga një anëtar i zgjedhur nga i Deleguari Kombëtar.

Mandati i të Deleguarve Kombëtar mund të rinovohet për çdo Kongres.

Neni 8

Me vendim të KNESHDM, marrë gjatë një mbledhjeje plenare, Presidentët që kanë lënë funksionet e tyre mund të vazhdojnë të jenë pjesë e Byrosë, por si anëtarë nderi dhe me të drejtë vote konsultative.

Neni 9

Byroja është organi ekzekutiv dhe teknik i KNESHDM. Byroja ka kompetenca të plota në fushën e buxhetit. Presidenti mund të thërrasë Komitetin e Ngushtë (që zgjidhet në çdo Kongres nga Byroja dhe që përbëhet nga të Deleguarit e tetë Shteteve Anëtare) për të marrë vendime urgjente. Megjithatë, Komiteti i Ngushtë nuk mund të marrë vendime në fushën e buxhetit.

Neni 10

Byroja mbledhet të paktën një herë në vit. Byroja mundet, gjithashtu, të mbledhet me kërkesë të Komitetit të Ngushtë, në këtë rast mbledhja thirret nga Drejtori i Përgjithshëm në vendin dhe datat e caktuara në marrëveshje me Presidentin.

Neni 11

Drejtori i Përgjithshëm siguron funksionimin shkencor dhe administrativ të KNESHDM. Ai raporton periodikisht për veprimet e tij pranë Presidentit dhe Byrosë.

Drejtori i Përgjithshëm është i asistuar nga një ekip i përhershëm anëtarët e së cilit janë të ngarkuar me misione shkencore, teknike ose administrative. Përgjatë gjithë kohëzgjatjes së misionit të tyre, anëtarët e ekipit të përhershëm janë nën varësinë ekskluzive të tij.

Neni 12

Me thirrje të Drejtorit të Përgjithshëm, KNESHDM mbledhet në Kongres dhe në Asamble plenare çdo tre vjet. Vendi dhe data zgjidhen me miratimin e Presidentit në bashkëpunim me autoritetet e vendit ku do të mbahet mbledhja. Në intervalet kohore mes Kongreseve, një kontakt i afërt mes kërkuesve shkencorë mesdhetarë mbahet nga studiot ndërkombëtare të organizuara nga KNESHDM mbi tema të specifike të aktualitetit.

Neni 13

KNESHDM i mbledhur në Kongres përcakton objektivat dhe punimet që do të ndiqen nga komitetet shkencore me mbështetjen e Shteteve nënshkruese.

Neni 14

Botimet bëhen në gjuhën frënge për sa i përket pjesës administrative dhe akteve zyrtare që i përkasin KNESHDM.

Neni 15

Këto statute shfuqizojnë dhe zëvendësojnë çdo dispozitë të mëparshme që rregullonte organizimin dhe funksionimin e KNESHDM.